



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Kabineti i Ministres së Drejtësisë - Ured Ministra Pravde - Office of the Minister of Justice

Nr. 39 / 2025

Datë: 12 / 02 / 2025

Në mbështetje të nenit 9, nenit 10 (paragrafi 1 dhe 2) dhe nenit 11 të Ligjit nr. 06/L-113 për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (GZ, nr. 7/01 mars 2019), në bazë të nenit 11 (paragrafi 1, nën-paragrafi 1.5) të Ligjit nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në përputhje me Shtojcën 1 (pika 3) të Rregullores QRK-Nr. 14/2023 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive si dhe nenit 46 (paragrafi 1) të Rregullores ZKM-Nr. 10/2023 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Ministrinë e Drejtësisë, Ministrja e Drejtësisë, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Znj. Edita Zenelaj, emërohet Zyrtare në Divizionin për Koordinimin e Procesit për Mbrojtjen Juridike dhe Mbështetjen Financiare të Personave të Akuzuar Potencial në Proceset Gjyqësore pranë Dhomave të Specializuara, në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë.
2. E emëruara nga pika (1) e këtij vendimi ushtron detyrat dhe përgjegjësitë e saj në pajtim me dispozitat përkatëse të Rregullores ZKM-Nr. 10/2023 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës së Ministrisë së Drejtësisë si dhe legjislacionin përkatës në fuqi.
3. Mandati i të emëruarës në pikën (1) të këtij vendimi fillon me datë 12/02/2025 dhe zgjatë deri më datë 11/02/2027, përkatësisht derisa të mos merret ndonjë vendim tjetër përkitazi me këtë çështje.
4. Të ardhurat personale të të emëruarës nga pika (1) e këtij vendimit do paguhën si pagë primare në vlerën e koeficientit 5.2.
5. Obligohet Divizioni për Burime Njerëzore dhe Divizioni për Buxhet dhe Financa për zbatimin e këtij vendimi.
6. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Albulena HAXHIU

Ministre e Drejtësisë

Vendimi iu dërgohet:

- Znj. Edita Zenelaj;
- Kabinetit të Ministres së Drejtësisë;
- Zyrës së Sekretares së Përgjithshme/MD;
- Divizionit për Burime Njerëzore/MD;
- Divizioni për Buxhet dhe Financa/MD;
- Divizionit për Koordinimin e Procesit për Mbrojtjen Juridike dhe Mbështetjen Financiare të Personave të Akuzuar Potencial në Proceset Gjyqësore pranë Dhomave të Specializuara;
- Arkivit të Ministrisë së Drejtësisë.